

[Të Reja](#) ▾[Policia e Shtetit](#) ▾[Shërbime](#) ▾[Baza ligjore](#)[Vendndodhjet e policisë](#)[Video](#)[Programi i transparencës](#) ▾[Kontakt](#)[Denonco Krimin Kibernetik](#)[Lajmet e Fundit:](#)[Lajmet](#)

14/07/2021

Lezhë – Vihet në pranga një 14-vjeçar që qarkullonte me armë zjarri pistoletë

Policia e Lezhës, kontrolle të shtuara në të gjithë qarkun, për kapjen e personave në kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo me lëndë narkotike.

Si rezultat i kontrolleve është vënë në prangat një 14-vjeçar që qarkullonte me armë zjarri pistoletë.

Gjithashtu, u shoqëruan për verifikim edhe 5 persona të tjerë me precedent të mëparshëm penal.

Në zbatim të planit të masave për mbajtjen nën kontroll të situatës kriminale, kapjen e personave në kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo lëndë narkotike, bazuar dhe në informacionet e siguruar në rrugë operative për persona që qarkullojnë me armë zjarri në automjet, shërbimet e Policisë Lezhë ushtruan kontrolle në disa automjete në Shëngjin, Lezhë e Milot.

Si rezultat, gjatë kontrollit të ushtruar në një mjet taxi në të cilin ishte pasagjer një 14-vjeçar, në çantën e tij, shërbimet e Policisë Lezhë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë me një krehër me fishekë.

Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E. T., banues në Lezhë, për veprën penale “Armëmbajtja pa leje” dhe materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

Kontrollet kanë vijuar edhe në Shëngjin, ku gjatë kontrolleve janë shoqëruar për verifikim 5 persona me precedent të mëparshëm kriminal.

Policia e Lezhës falënderon qytetarët për mbështetjen dhe besimin dhe i fton ata për të denoncuar në Komisaratin Dixhital dhe në numrin 112, çdo rast të paligjshmërisë, duke iu siguruar anonimat të plotë dhe reagim të menjëhershëm e të paanshëm nga strukturat e Policisë së Shtetit.



Share



Share



Share



Share



Email

[Kërko](#)[Komisariati Dixhital](#)

GET IT ON

Google Play

Download on the
App Store[Arkiva](#)[Linqe](#)

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

[◀ Lushnjë – Bien në pranga 2 autorët e dyshuar të vjedhjes së disa automjeteve](#)[Durrës – Kapet dhe ndalohet një 24-vjeçar i dënuar me 5 vjet e 6 muaj burgim për veprën penale “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufijve” ▶](#)